



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2023

**Lënda:** Kthim përgjigje

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë e organizatës që ju drejtoni, në përgjigje të kërkesës tuaj, regjistruar me numër rendor 25, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin Nr. 4514 prot., datë 10.08.2023, në bazë të të dhënave që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore, dhe bazuar në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Z. {...} ka kryer studimet Bachelor pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti Justiniani, Tiranë në vitet akademike 2009-2012, me numër diplome {...}, lëshuar në datë 27.06.2012.

Në vitet 2012-2014 ka kryer ciklin e dytë të studimeve në programin “Master i Shkencave në Drejtë Penale” pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, me numër diplome {...}, lëshuar në datë 07.07.2015.

Ndërkohë në periudhën 2019-2022 ka kryer studimet në Shkollën e Magjistraturës, Tiranë, duke fituar titullin “Magjistrat” në profilin gjyqtar, me numër diplome {...}.

Me anë të vendimit Nr. 313, datë 20.07.2022, të Këshillit të Lartë të Gjyqësor, z. {...} është emëruar gjyqtar.

Këshilli i Lartë i Gjyqësor, me vendimin Nr. 327, datë 22.07.2022, ka vendosur që gjyqtari i emëruar z. {...} të caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}.

Z. {...} është certifikuar me titullin “Avokat”, nga Dhoma Kombëtare e Avokatëve, Tiranë, me numër license {...}, lëshuar më 30.10.2015. Gjithashtu disponon certifikatën për gjuhën angleze lëshuar nga University of Cambridge, me numër {...}, lëshuar në datë 17.07.2007.

Bashkëlidhur lutemi gjeni edhe formularin e vetëdeklarimit për zbatimin e ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i cili gjendet edhe në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në Programin e Transparencës.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!